

# SMART BOX

APARAT MARRËS TOKËSOR

Manual Përdorimi



# UDHËZIME SIGURIE



Ky produkt është prodhuar konform standardeve ndërkombëtare të sigurisë. Ju lutemi, lexoni udhëzimet e sigurisë dhe funksionimit përpara se ta vini aparatit në punë. Ruajeni këtë manual që ta konsultoni kur është e nevojshme. Informacioni i këtij manuali përdorimi mund të modifikohet pa njoftim paraprak.

## HYRJA E RRYMËS

AC 90~250V~, 50/60Hz.

Produkti duhet të vihet në punë vetëm me voltazhin e treguar në etiketë.

Hiqeni aparatit nga priza para se ta pastroni ose ta montoni.

## MBINGARKESA

Mos e mbingarkoni prizën, zgjatuesin apo përshtatësin, pasi ka rrezik për shkarkesë elektrike ose zjarr.

## LËNGJET

Aparati nuk duhet të bjerë në kontakt me ujin apo lëngje të tjera.

Mos vendosni në pajisje objekte të mbushura me ujë, si vazo apo gota.

## PASTRIMI

Para pastrimit, hiqni kabllon e furnizimit me rrymë nga priza. Për ta pastruar nga jashtë përdorni një leckë të thatë (mos përdorni tretës kimik).

## AJROSJA

Vrimat e ajrimit në pjesën e sipërme të aparatit duhet të mos mbulohen, me qëllim që ajri të qarkullojë lirshëm. Mos e vendosni aparatit mbi sipërfaqe të buta apo tepihë. Mos e ekspozoni aparatit direkt në dritën e diellit apo pranë burimeve të nxehtësisë. Mos vendosni pajisje elektronike mbi aparat.

## OBJEKTE FIKSUESE

Përdorni vetëm objektet fiksuese të rekomanduara nga fabrika, përndryshe përbën rrezik ose dëmtim të aparatit.

# UDHËZIME SIGURIE



## LIDHJA ME TV DHE ANTENË

Shkëputeni aparatin nga priza, para se ta lidhni me kabllin e antenës. Mosrespektimi i këtij udhëzimi mund të rezultojë në dëmtim të televizorit ose/dhe aparatit.

## VENDNDODHJA

Vendoseni aparatin në ambient të mbyllur, ku nuk ekspozohet ndaj dritës së diellit, shiut apo vetëtimage. Mos e vendosni aparatin afër burimeve të nxehtësisë si radiatorë, pajisje ngrohëse, stufa, apo pajisje të tjera (përfshi amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi. Gjithashtu rekomandohet të mos vendosni aparatin afër telefonave pa tel apo pajisjeve wireless.

## GJATË VETËTIMAVE, STUHISË ose KUR NUK ËSHTË NË PËRDORIM

Shkëputeni aparatin nga priza kryesore si dhe hiqeni kabllin gjatë motit me vetëtima, stuhi, apo gjatë mospërdorimit për një kohë të gjatë.

## SERVISIMI

Mos tentoni të riparoni produktin vetë, sepse hapja e aparatit mund t'ju ekspozojë ndaj voltazhit të lartë apo rreziqeve të tjera. Për servisim, kontaktoni me personelin e kualifikuar të servisit. Çdo ndërhyrje e pa autorizuar në aparat e nxjerrë atë jashtë garancisë.

**Mos e tërhiqni kabllin kryesor kur aparati është në punë. Për ta fikur aparatin, shtypni butonin "Fikje/Ndezje" në telekomandën tuaj apo te njësia.**



Udhëzimet e Sigurisë .....1-2

## KAPITULLI 1

**Para montimit** ..... 5  
Karakteristika të përgjithshme ..... 5  
Aksesorët ..... 5

## KAPITULLI 2

**Butonat dhe funksionet** .....6  
Paneli ballor dhe i pasmë ..... 6-7  
Telekomanda ..... 8

## KAPITULLI 3

**Vendndodhja e marrësit** ..... 9  
Vendndodhja e marrësit ..... 9  
Lidhja e marrësit me TV ..... 9-10-11  
Lidhja e sistemit dixhital audio ..... 12

## KAPITULLI 4

**Instalimi fillestar dhe funksionet bazë** ..... 13  
Operacionet ..... 13  
Instalimi fillestar ..... 13  
**Funksionet Bazë** ..... 13  
Ndërrimi i kanalit ..... 13  
Kontrolli i volumit ..... 13  
Informacioni i eventeve ..... 14  
Teleteksti ..... 14

Përzgjedhja e gjuhës audio ..... 15  
Përzgjedhja e titrave ..... 15  
Guida elektronike e programeve GUIDE ..... 15-16

## KAPITULLI 5

**Harta e menisë** ..... 17-18  
**Menuja kryesore** ..... 19  
**TV** ..... 19  
Guida TV ..... 19  
Kërkimi ..... 19  
Kujtesat ..... 20  
Lista TV ..... 20  
**Të preferuara** ..... 20-21  
**PVR** ..... 21  
Regjistrimet e rezervuara ..... 21  
Regjistrimet në proces ..... 21-22  
Regjistrimet e përfunduara ..... 22-23  
Regjistrime të dështuara ..... 23  
Planifikimi i regjistrimit manual ..... 23-24  
Krijoi direktori të re ..... 24  
Modifiko direktorinë ..... 24  
**Radio nga Interneti** ..... 25  
Radio nga Interneti ..... 25  
**Kontrolli prindëror** ..... 25  
Ndrysho PIN ..... 25  
Blloko kanale ..... 25  
**Karta smart** ..... 26



<b>Konfigurimet</b> .....	26
Instalimi i kanaleve .....	26
Të dhëna mbi kanalën .....	26
Parametrat e orës .....	26
Parametrat e daljes A/V .....	26-27
Gjuhët .....	27
Ndërfaqja e përdoruesit .....	27-28
Parametrat e sistemit .....	28
Informacioni për sistemin .....	28
<b>Funksionet PVR</b> .....	29
Regjistrimi i menjëhershëm .....	29
Regjistrimi EPG .....	29
Playback .....	28
<b>Ndihmesë</b> .....	30




## PARA MONITIMIT

### KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

- 1 Tunera DVB-C
- MPEG-2 (MP@ML), MPEG-2 (MP@HL), MPEG4 AVC/H.264, HP@L4
- OSD Teletext
- GUIDE (Guida elektronike e programit/EPG) për informacione të kanalit që shfaqen në ekran
- Kontrolli prindëror
- Dalje HD numerike HDMI
- Dalje analoge SD SCART
- Dalje analoge SD RCA
- Dalje optike S/PDIF
- 2 x USB + 1 x eSATA
- Përditësim automatik /manual softueri
- 1 x Portë ethernet

### AKSESORËT

- Manuali i përdorimit
- Telekomanda
- Bateritë (AAA)
- Kablli HDMI
- Kablli analog
- Furnizues i jashtëm 12 V 3 A



# KAPITULLI 2



## BUTONAT DHE FUNKSIONET

### PANELI BALLOR

- 1 Ndezje / Fikje
- 2 Porti i kartelës SMART, vedoset me çip në drejtim të poshtëm.



# KAPITULLI 2



## PANELI I PASMË



- 4** **DALJE**  
Port dalje i sinjalit
- 5** **HYRJE**  
Porti i furnizimit me sinjal
- 6** **AV OUT**  
Porti i lidhjes së sinjalit analog me TV (RCA)

- 7** **ETHERNET**  
Porti i lidhjes së kablos së internetit
- 8** **PORT PËR USB**  
Port USB për lidhjen e memorjes së jashtme ose WiFi USB.
- 9** **S/PDIF DALJE**  
Port audio dalje digjitale


- 10** **HDMI**  
Port daljeje e sinjalit digjital, për lidhje me TV.
- 11** **USB2**  
Port USB për lidhjen e memorjes së jashtme ose WiFi USB.
- 12** **LIDHËSE ELEKTRIKE DC**  
Porti i furnizimit me rrymë.



# KAPITULLI 2



## TELEKOMANDA






## VENDNDODHJA E MARRËSIT

### VENDNDODHJA E MARRËSIT

- Vendoseni marrësin në pozicion horizontal.
- Mos vendosni mbi marrës objekte të rënda si TV.
- Mos e instaloni marrësin në këto ambiente: vende me vibrime, me ekspozim direkt në rrezet e diellit, vende të lagështa, ambiente me temperatura shumë të larta ose shumë të ulëta, si dhe ambiente pa ajrosje.

### LIDHJA E MARRËSIT ME TV

Për të lidhur marrësin me televizorin, ekzistojnë 2 metoda të ndryshme: me kabëll HDMI (rekomandohet), RCA.




# KAPITULLI 3



## 1 HDMI

Lidhni kabljin HDMI me terminalin "HDMI" në panelin e pasmë të marrësit dhe skajin tjetër lidhjeni me input HDMI të televizorit tuaj.




# KAPITULLI 3



## 2 AV

Lidhni kabllin RCA me daljen "RCA" në panelin e pasmë të marrësit dhe skajin tjetër lidhjeni me hyrjen RCA të televizorit tuaj.




# KAPITULLI 3



## LIDHJA E SISTEMIT DIXHITAL AUDIO

Lidhni kabljin optik me lidhësin “S/PDIF” në panelin e pasmë të marrësit, dhe skajin tjetër lidhjeni me lidhësin S/PDIF INPUT OPTICAL në sistemin dixhital audio.



# KAPITULLI 4



## INSTALIMI FILLESTAR DHE FUNKSIONET BAZË

### FUNSKIONET BAZË

Ky seksion shpjegon shumë funksione për TV dhe Radio.

### NDËRRIMI I KANALIT

Kanali ndërrohet me tri metoda.

- **Metoda 1) Shtyp Shigjetat (▲/▼) ose PR+/-.**
- **Metoda 2) Shtyp Numrat (0~9)** që të zgjedhësh kanalin direkt.
- **Metoda 3) Shtyp OK** që të shfaqet lista e kanaleve. Zgjidh kanalin që dëshiron duke përdorur Shigjetat (▲/▼) dhe shtyp **OK**.

\*Shtyp **Last** për t'u kthyer te kanali i mëparshëm. Shtyp TV/Radio  për të kaluar te kanalet TV dhe Radio.

### KONTROLLI I VOLUMIT

Për të kontrolluar volumnin:

- Shtyp **VOL +/-** ose Shigjetat (◀/▶).
- Shtyp butonin **Mute** (🔇) për të hequr zërin.
- Shtypn prapë **Mute** (🔇) ose VOL +/- për të rikthyer zërin.

# KAPITULLI 4



## INFORMACIONI I EVENTEVE

Shtypni butonin **Info** për të paraqitur në ekran këto informata:

- 1 emri i listës së kanalit
- 2 numri/emri i kanalit
- 3 informacion shtesë për programin
- 4 titulli i programit aktual
- 5 titulli i programit pasardhës
- 6 ora/data aktuale
- 7 ikonat (ekran i gjerë, audio nga disa kanale, kyçje, titra, HD, gjuha audio, teletext, kufizimi i moshës)



Po të shtypni sërish **Info**, djathtas shfaqet informacion i hollësishëm për programin. Strisha dhe informacioni zhduken nëse e shtypni butonin **Info** për herë të tretë.

## TELETEKSTI

Për të parë teletekstin:

1. Shtyp butonin **Teletext** (T) për të shfaqur shërbimin e teletekstit, nëse ka.
2. Me **Shigjetat** (▲/▼) ose **Numrat (0~9)** ndërroni faqet.  
Me **Shigjetat** (◀/▶) kaloni në nënfaqe, nëse ka.





# KAPITULLI 4

3. Për të dalë nga teleteksti, shtyp butonin **Teletext** (T) prapë. Shtypja e parë shfaq modalitetin Teletekst transparent. Shtypja e dytë e mbyll shërbimin e Teletekstit.

## PËRZGJEDHJA E GJUHËS AUDIO

Për të zgjedhur gjuhën audio:

1. Shtyp butonin **Audio** (A) dhe butonin **OK** për të shfaqur menunë e Gjuhës Audio.
2. Zgjidh gjuhën duke përdorur Shigjetat (▲/▼) dhe shtyp **OK** për të konfirmuar zgjedhjen tënde.



## PËRZGJEDHJA E TITRAVE

Për të përzgjedhur gjuhën e titrave:

1. Shtyp butonin **Titrat** (T) dhe **OK** për të shfaqur menunë e gjuhës së titrave.
2. Zgjidh gjuhën e titrave me **Shigjetat** (▲/▼) dhe shtyp **OK** për të konfirmuar zgjedhjen tënde.

## GUIDA ELEKTRONIKE E PROGRAMEVE GUIDE

Guida Elektronike e Programeve shfaq informacion për programin, si p.sh. numrin/emrin e kanalit, titujt e programit, orarin e transmetimit, si dhe sinopsin e programit. Shërbimi **GUIDE** mund të ndryshojë në varësi të ofruesit të shërbimit.

1. Shtyp **GUIDE** për të hyrë në Guidën Elektronike të Programeve.
2. Zgjidh një program për të parë më shumë informacion për të.



- **Shigjetat** (▲/▼): Lëviz fokusin e programit lart/poshtë të një kanali tjetër në boksën e programeve. Në modalitet me një kanal, lëviz fokusin lart/poshtë në listën e programeve.
- **Shigjetat** (◀/▶): Lëviz fokusin e programit majtas/djathtas orarit në të njëjtin kanal. Në modalitet me një kanal, lëviz kanalën që po shikoni.



# KAPITULLI 4



- **Butonat Faqje (▲/▼):** Lëvizni lartë/poshtë kanalet (ose programet në mënyrën e kanalit) një fletë në kohë.
- **Butoni i Verdhë:** Sposton orarin EPG një ditë para.
- **Butoni i Gjelbër:** Kalon orarin në orën aktuale.
- **Butoni i Kuq:** Sposton orarin një ditë mbrapa.

\*Orari shfaq programet me intervale njëorëshe. Viza vertikale e kuqe shënon orën aktuale.

3. Për të ndryshuar modalitetin **GUIDE** (Grid, Listë) shtyp sërish butonin **GUIDE**.

4. Për të përdorur funksionet shpesë, shtyp **Opt** ose **OK**.

(1) **Luaj:** Kaloni te kanali i zgjedhur.

(2) **Më kujto:** Bën një njoftim për t'ju kujtuar kur fillon programi.

(3) **Regjistron:** Përcaktoni programin që doni të regjistroni (vetëm model PVR).

(4) **Trego të ngjashme:** Gjen programet e ngjashme në Guide.

(5) **Më shumë informacion:** Tregon më shumë informacion për programin e zgjedhur, djathtas ekranit.

5. Për të dalë nga **GUIDE**, shtyp butonin **EXIT**.



# KAPITULLI 5



## HARTA E MENUSË

<b>TË PREFERUARAT</b>	HDTV, TV / Radio
<b>TV</b>	Guida TV, kërkë sipas emrit, kërkë sipas kategorise / Rezervime / Lista e kanaleve
<b>PVR</b>	Regjistrimet e rezervuara, regjistrimet në proces, regjistrimet e përfunduara regjistrimet e dështuara
<b>RADIO</b>	
<b>VOD</b>	
<b>RADIO NGA INTERNET</b>	
<b>WEB NË TV</b>	
<b>DLNA</b>	
<b>SOCIAL MEDIA</b>	
<b>EXTRA</b>	
<b>USB</b>	
<b>KONTROLL PRINDËROR</b>	Konfiguro, ndrysho PIN, blloko kanale
<b>KARTELA SMART/CONAX</b>	Rreth Conax CA, statusi i pajtimit, statusi i eventit, statusi token, mesazhet limiti i moshës, ndrysho CA PIN

# KAPITULLI 5



KONFIGURIMI		
	Instalimi i kanaleve	Kërkim automatik i kanaleve, kërkim manual i kanaleve
	Të dhëna mbi kanalin	Raporti i figurës TV, shfaq format (SCART), shfaq format (HDMI), digital audio, S/PDIF A/V Sync gjuha audio e preferuar, tipi i sinjalit SCART formati video HDMI
	Parametrat e daljes A/V	
	Gjuhët	Menuja e gjuhës, gjuha e parë audio, gjuha e dytë audio gjuha e parë për titrat, gjuha e dytë për titrat titra për vështirësi në të dëgjuar
	Ndërfaqje përdoruesi	Marzhi PVR Start, Marzhi PVR fund Vetëfshirje - Regjistrimet më të vjetra afati i screensaver Strisha OSD/Banner
	Parametrat e sistemit	Ristarto aparatit, ktheje në gjendjen fillestare
	Informacion për sistemin	Rrjeti IP, konfigurimi, rrjetit softuer, çip ID

# KAPITULLI 5



## MENUJA KRYESORE

Menuja kryesore përbëhet nga:

- Të preferuarat
- TV
- PVR
- VOD
- WEB
- Radio nga interneti
- DLNA
- Ekstra
- USB
- Kontrolli prindëror
- Karta smart
- Konfigurimet

## TV

### GUIDA TV

1. Zgjidh Guida TV duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë **TV** dhe shtyp **OK**.
2. Do të shfaqet Guida TV (EPG).

### KËRKIM

- Kërko sipas emrit
- Kërko sipas kategorisë

1. Zgjidh Kërkim duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë **TV** dhe shtyp **OK** për të hapur “Tastierën”.
2. Fut një fjalë kyçe duke përdorur **Shigjetat (▲/▼/◀/▶)** dhe **OK**. Pastaj zgjidh **Enter** dhe shtyp **OK** për të filluar kërkimin.
3. Një listë programesh të ngjashme do të shfaqen në ekran (nëse ka të ngjashme).



# KAPITULLI 5

## KUJTESAT

Kjo menu rendit të gjitha kujtesat:

1. Zgjidh "**Kujtesat**" duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë **TV** dhe shtyp **OK**.
2. Shfaqet lista e "Kujtesave".
3. Shtyp butonin **Opt** që të hapen më shumë opsione.
  - (1) **Fshi**: Fshinë kujtesën e përzgjedhur.
  - (2) **Fshi të gjithë**: Fshinë të gjitha kujtesat.

## LISTA TV

Kjo pjesë e menisë rendit të gjitha kanalet TV dhe informacionin për programet e tyre aktuale.

### TË PREFERUARAT

Zgjidh "Të preferuara:" duke përdorur **Shigjetat (◀/▶)** dhe shtypni **OPT** që të hapni më shumë opsione.

1. Shtyp **Menu** për të hapur Menunë. Menuja hapet në gjendjen që është mbyllur herën e fundit.
2. Me **Shigjetat (▲/▼/◀/▶)** kalo lart, poshtë, majtas, djathtas menuse.
3. Navigo në nën menunë që kërkon dhe shtyp **OK** për të konfirmuar zgjedhjen tënde.
4. Përdor **Shigjetën (◀)** për t'u kthyer te menuja e mëparshme.
5. Për të dalë nga menuja aktuale, shtyp butonin **Back/Exit**.

(1) **Shto listë të re**: Krijon listë të re kanalesh të preferuara.

(2) **Fshi listën**: Heq listën ekzistuese. Nuk hiqen listat e fabrikës (HDTV, TV, Radio).

(3) **Riemëro listën**: I ndryshoni emrin një listë (max. 10 shkronja)

(4) **Ri-sistemo**: Risistemon kanalet në listë. Pasi mbaron risistemimi, shtyp **Shigjetën (▶)** dhe pastaj shtypni **Ruaj** dhe **OK** për të ruajtur ndryshimet.



# KAPITULLI 5

(5) **Shto/heq:** Shton/heq kanalet në listën e përzgjedhur. Pasi shton/heq kanalet, shtyp **Shigjetën (▶)** dhe pastaj **ruaj** dhe **OK** për të ruajtur ndryshimet.

PVR

## REGJISTRIMET E REZERVUARA

Kjo menu rendit regjistrimet që janë planifikuar për t'u regjistruar.

1. Zgjidh "Regjistrimet e rezervuara" duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë **PVR** dhe shtyp **OK**.
2. Shfaqet lista e regjistrimeve aktive.
3. Shtyp **OPT** në listën e regjistrimeve të rezervuara për të hapur më shumë opsione.

(1) **Përpuno:** Shfaq një menu shtesë për të ndryshuar detajet e planifikimit (Kanalin, datën, orën e fillimit, orën e mbarimit, përsëritjen). Pasi ndryshoni detajet, shtypni **Ruaj** dhe **OK** për të ruajtur ndryshimet.

(2) **Blloko/Zhblloko:** Blloko ose zhblloko regjistrimin e përzgjedhur. Regjistrimet e bllokuara nuk fshihen dot.

(3) **Lëviz:** Lëviz/sposton regjistrimin e përzgjedhur në një skedar tjetër.

(4) **Fshi materialin:** Fshinë regjistrimin e planifikuar.

(5) **Fshi gjithë të rezervuarat:** Fshinë të gjitha regjistrimet e planifikuara.

(6) **Më shumë informacion:** Përshkrim i gjatë i guidës për atë material.

## REGJISTRIMET NË PROCES

Kjo menu rendit eventet që janë aktualisht duke u regjistruar.

1. Zgjidh regjistrimet në proces duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë **PVR** dhe shtyp butonin **OK**.



# KAPITULLI 5



2. Shfaqet lista e regjistrimeve në vazhdim.
3. Shtyp **OPT** në listën e regjistrimeve në vazhdim për të hapur më shumë opsione:

(0) **Shiko:** Shfaq atë event që po regjistron.

(1) **Vazhdo:** Vazhdo shikimin e një regjistrimi aktiv.

(2) **Shiko nga fillimi:** Luaj një regjistrim aktiv nga fillimi.

(3) **Ndalo:** Ndalo një regjistrim aktiv. Këtë skedar e gjeni në “Regjistrimet e përfunduara”.

(4) **Përpuno:** Shfaq një menu shtesë për të ndryshuar detaje të planifikimit (Kanalin, datën, orën e fillimit, orën e mbarimit, përsëritjen). Pasi bën ndryshimet, shtyp **Ruaj** dhe **OK** për të ruajtur ndryshimet.

(5) **Blloko/Zhblloko:** Blloko ose zhblloko regjistrimet e përzgjedhura. Regjistrimet e kyçura nuk fshihen dot.

(6) **Lëviz:** Lëviz/sposton regjistrimin e përzgjedhur në një skedar tjetër.

(7) **Fshi materialin:** Ndalon regjistrimin e përzgjedhur dhe e fshinë.

(8) **Fshi gjithë aktivet:** Ndalon dhe fshinë të gjitha regjistrimet në vazhdim.

(9) **Më shumë informacion:** Përshkrim i gjatë i guidës për atë material.

## REGJISTRIMET E PËRFUNDUARA

Kjo menu rendit regjistrimet e përfunduara.

1. Zgjidh regjistrimet e përfunduara duke përdorur **Shigjetat** (▲/▼) në menunë **PVR** dhe shtyp **OK**.

2. Shfaqen regjistrimet e përfunduara.

3. Shtyp **OPT** në listën e regjistrimeve të përfunduara për të hapur më shumë opsione:

(1) **Vazhdo:** Vazhdo shikimin e një regjistrimi aktiv.

(2) **Shiko nga fillimi:** Luaj një regjistrim aktiv nga fillimi.

(3) **Blloko/Zhblloko:** Blloko ose zhblloko regjistrimet e përzgjedhura. Regjistrimet e kyçura nuk fshihen dot.

(4) **Lëviz:** Lëviz/sposton regjistrimin e përzgjedhur në një skedar tjetër.



# KAPITULLI 5



- (4) **Fshi materialin:** Ndalon regjistrimin e përzgjedhur dhe e fshinë.
- (5) **Fshi të gjithë:** Fshinë gjithë materialet e përfunduara.
- (6) **Më shumë informacion:** Përshkrim i gjatë i guidës për ate material.

## REGJISTRIME TË DËSHTUARA

Kjo menu rendit regjistrimet që nuk janë realizuar. Një regjistrim mund të dështojë, për shembull, kur energjia elektrike shkëputet gjatë regjistrimit.

## PLANIFIKIMI I REGJISTRIMIT MANUAL

- 1. Shtyp butonin **OPT** në menunë **PVR**. Zgjidh "Rezervo regjistrim manual" duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** dhe shtyp **OK**.
- 2. Një menu për konfigurimin e regjistrimit shfaqet në anën e djathtë të ekranit.
- 3. Me **Shigjeta (▲/▼)** zgjidh një opcion dhe shtyp **OK** për ta ndryshuar. Opcionet e mundshme renditen më poshtë:

(1) **Kanal:** Me këtë opcion, hapet një listë kanalesh.

Me **Shigjetat (▲/▼)**, shtyp kanalën që dëshiron të regjistrosësh dhe shtyp **OK**.

(2) **Datë:** Me këtë opcion, hapet një menu kalendar.

Me **Shigjetat (▲/▼)** shkoni në datën që doni dhe shtypni **OK**.

(3) **Ora e fillimit:** Me këtë opcion hapet një menu për rregullimin e orës së fillimit.

Me **Shigjetat (◀/▶)** ndryshoje orën me nga 5 minuta. Për të shënuar orën, mund të përdorësh edhe **numrat 0-9**. Në fund, shtyp **OK** për të ruajtur orën.

(4) **Koha e mbarimit:** Me këtë opcion hapet një menu për rregullimin e orës së mbarimit.

Me **Shigjetat (◀/▶)** ndryshoje orën me nga 5 minuta. Për të shënuar orën, mund të përdorësh edhe **numrat 0-9**. Në fund, shtyp **OK** për të ruajtur orën.

(5) **Përsërit:** Me këtë opcion hapet një menu për të ndryshuar opcionet e përsëritjes. Me **Shigjetat (▲/▼)**.





# KAPITULLI 5



Zgjidhni një opcion dhe shtypni **OK** për ta ruajtur. Opcionet e mundshme janë: Disabled (Çaktivizuar), Daily (Përditë), Weekly (Javor), ose Weekday (Ditë jave).

4. Pasi zgjidhen optionet, shtyp **Save** dhe **OK** për të ruajtur regjistrimin manual.

## KRIJO DIREKTORI TË RE

1. Shtyp butonin **OPT** në menunë **PVR**. zgjidh "Krijo direktori të re" duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** dhe shtyp **OK**.
2. Një tastierë virtuale për të shkruar emrin e direktorisë së re, shfaqet në anën e djathtë të ekranit.
3. Vendosi emrin direktorisë duke përdorur **Shigjetat (▲/▼/◀/▶)** dhe **OK**. Pastaj shtyp **enter** dhe **OK** për ta ruajtur.
4. Direktoria e re do të shfaqet në menunë **PVR**.

## MODIFIKO DIREKTORINË

1. Zgjidh direktorinë që dëshiron të modifikosh, duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë **PVR** dhe shtyp **OPT**.
2. Një menu për modifikimin e direktorisë shfaqet në anën e djathtë të ekranit.
3. Me **Shigjetat (▲/▼)** zgjidh një funksion dhe shtyp **OK**.

Funksionet e mundshme renditen më poshtë:

**(1) Ri-emërto direktorinë:** Ky funksion hap një tastierë virtuale për t'i vënë emër të ri direktorisë, duke përdorur **shigjetat (▲/▼/◀/▶)** dhe **OK**. Pastaj zgjidh enter dhe shtyp **OK** për ta ruajtur.

**(2) Fshi direktorinë:** Ky funksion fshin direktorinë e zgjedhur dhe regjistrimet që mund të ketë brenda.



# KAPITULLI 5



## RADIO NGA INTERNETI

### RADIO NGA INTERNETI

Kjo pjesë e menisë shfaq të gjitha kanalet radiofonike nga interneti.

## KONTROLLI PRINDËROR

### NDRYSHO PIN

1. Selektu **"Ndrysho Kodin PIN"** duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë e kontrollit prindëror dhe shtyp **OK**.
2. Shfaqet tabela për ndryshimin e PIN-it.
3. Fut PIN-in e vjetër duke përdorur **numrat 0~9**.
4. Fut PIN-in e ri duke përdorur **numrat 0~9**.
5. Fut PIN-in e ri sërish për konfirmim.

**PIN i fabrikës është "0000"**.

### BLLOKO KANALE

1. Selektu **"Blloko Kanalet"** duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë e Kontrollit Prindëror dhe shtyp **OK**.
2. Shfaqet tabela që kërkon konfirmim autentik.
3. Fut një PIN me **numra 0~9** dhe shtyp **OK**. Nëse PIN është i saktë, shfaqet menuja për bllokimin e kanaleve.
4. Selektu kanalet që do të bllokosh, duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** pastaj shtyp **OK** për të kyçur ose hapur një kanal.



# KAPITULLI 5



## KARTA SMART

Kur fusni një kartë smart Conax, menuja e saj shfaqet në këtë pjesë të menisë. Ju lutemi vendoseni kartën siç duhet, me çip poshtë.

## KONFIGURIMET

### INSTALIMI I KANALEVE

Pasi të futni kodin e aparatit (0000) do të shfaqet menuja e mëposhtme:

- **Kërkimi automatik i kanaleve**
- **Kërkimi manual i kanaleve**

### TË DHËNA MBI KANALIN

Kjo pjesë e menisë mund të përdoret për të parë parametrat e kanalit dhe statusin e sinjalit të kanalit televiziv.

### PARAMETRAT E ORËS

Kjo menu përdoret për rregullimet e orës së aparatit.

### PARAMETRAT E DALJES A/V

1. Zgjidh "**Parametrat e daljes A/V**" duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë "Konfigurimet" dhe shtyp **OK**.
2. Zgjidh opsionet që do të modifikosh duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** dhe shtyp **OK**.
3. Zgjidh një vlerë për secilin opsion duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** dhe shtyp **OK**. Vlerat e mundshme renditen në vijim:



# KAPITULLI 5

- (1) **Përmasat e figurës TV:** 16:9, 4:3, ose Auto
- (2) **Formati i figurës (RCA):** Ekran i plotë, me kashe, i zgjatur
- (3) **Formati i imazhit (HDMI):** Ekran i plotë, me kashe, i zgjatur
- (4) **Digital audio:** Multikanal ose stereo
- (5) **S/PDIF A/V Sync:** 0~250ms
- (6) **Pista e preferuar audio:** Normale, për të shurdhërit, për të verbrit
- (7) **Tipi i sinjalit SCART:** CVBS ose RGB
- (8) **Formati video HDMI:** Automatik, 576p, 720p, 1080i, ose format origjinal

## GJUHËT

1. Zgjidh gjuhët duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë **Konfigurimi** dhe shtyp **OK**.
2. Zgjidh opsionet e një gjuhe, duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** dhe shtyp **OK**. Opsionet e mundshme janë:
  - (1) **Gjuha e menisë**
  - (2) **Gjuha e parë e Audios**
  - (3) **Gjuha e dytë e Audios**
  - (4) **Gjuha e parë e Subtitrave**
  - (5) **Gjuha e dytë e Subtitrave**
  - (6) **Subtitra për vështirësi në dëgjim**
3. Zgjidh një vlerë për çdo opcion të gjuhës duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** dhe shtyp **OK**.

## NDËRFAQJA E PËRDORUESIT

1. Zgjidh ndërfaqja përdoruesit duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menu dhe shtyp **OK**.
2. Zgjidh një opcion duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** dhe shtyp **OK**. Opsionet e mundshme renditen më poshtë:

- (1) **Transparenca e menisë**
- (2) **Paraqitja grafike**
- (3) **Fonti i aplikimit**

# KAPITULLI 5



(4) **Renditja e të preferuarave**

(5) **Ora e panelit ballor në Standby**

(6) **Toleranca fillestare e PVR:** Ky opcion bën që të gjitha regjistrimet e planifikuara të fillojnë më herët (i/e çaktivizuar, 1, 2, 5, 10 minuta).

(7) **Toleranca fundore e PVR:** Koha që i shtohet automatikisht çdo regjistrimi pas orës kur programi pritët të mbarojë (i/e çaktivizuar, 5, 10, 15, 20 ose 30 minuta).

(8) **Fshi automatikisht regjistrimet e vjetra:** Po e aktivizuat këtë opcion, regjistrimet më të vjetra në secilin skedar fshihen në momentin kur tejkalohet kuota. Ky opcion nuk vlen nëse kuota është vendosur e pakufizuar.

(9) **Kuota PVR e paracaktuar**

(10) **Kohëzgjatja e Screensaver:** Nëse nuk bëni asnjë veprim, screensaver shfaqet pas këtij interвали kohor: (Çaktivizuar, 5, 10, ose 15 minuta). Aktivizohet në menu dhe radio.

(11) **Koha e shfaqjes së grafikave**

(12) **Koha e fikjes automatike**

## PARAMETRAT E SISTEMIT

1. Zgjidh "Parametrat e sistemit" duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë "Konfigurimet" dhe shtyp **OK**.

2. Zgjidh një veprim duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** dhe shtyp **OK**. Opcionet renditen më poshtë:

(1) **Ristarto pajisjen:** Nëse zgjedh këtë opcion dhe pastaj OK, aparati ristarohet (fiket dhe ndizet).

(2) **Rikthim në gjëndjen fillestare:** Me këtë opcion, aparati kthehet në gjëndjen e fabrikës/fillestare. Për këtë veprim nevojitet PIN.

(3) **Parametrat e rrjetit:** Në këtë menu vendosen parametrat e rrjetit për t'u lidhur në rrjet. Nga fabrika është vendosur lloji i rrjetit DHCP (merr adresë IP automatikisht nga router-i).

## INFORMACION PËR SISTEMIN

1. Zgjidh "Informacion për sistemin" duke përdorur **Shigjetat (▲/▼)** në menunë **Konfigurimet** dhe shtyp **OK**.

(1) Rjeti IP

(1) Chip id

(2) Software

(2) Lidhja me serverin MW

# KAPITULLI 5



## FUNKCIONET PVR

Mos tërhiq kordonin kryesor gjatë regjistrimit / Mund të shkaktojnë dëmtim të hard drive. Shtypni butonin “Power” në telekomandë ose aparatën marrës për ta fikuar.

### REGJISTRIM I MENJËHERSHËM

1. Shtyp **Record** (●) për të regjistruar programin aktual menjëherë.
2. Nëse shtyp **Stop** (■) shfaqet lista e regjistrimeve në proces.
3. Zgjidh kanalën e regjistrimit dhe shtyp **OK**.

Funksionet e mundshme renditen më poshtë:

- (1) **Stop**: Regjistrimi në vazhdim ndalon.
- (2) **Play**: Shfaqet kanali ku bëhet regjistrimi në vazhdim.
- (3) **Anulo**: Mbyllet tabela.

### REGJISTRIMI EPG

Ju lutemi, referojuni Guidës Elektronike të Programeve (GUIDE).

### PLAYBACK

Këto butona përdoren gjatë kohës që luani një material të regjistruar:

- (1) **Stop** (■): Ndalon materialin që po luhet
- (2) **PVR**: Kthehet te lista e regjistrimeve të përfunduara
- (3) **REW** (◀◀): materiali kthehet mbrapa
- (4) **Play/Pause** (▶/■): Luan/ndalon materialin.
- (5) **FF** (▶▶): E kalon përpara shpejt materialin.




PROBLEMI	ZGJIDHJA
Nuk ka rrymë.	Fusni kabllon e adapterit në rrymë.
Nuk ka figurë.	Sigurohuni që kabllot e videos dhe antenës janë lidhur siç duhet. Sigurohuni që në TV keni zgjedhur hyrjen e duhur video.
Nuk ka zë.	Kontrollo nivelin e volumit të TV dhe të marrësit. Sigurohuni që nuk keni aktivizuar Mute te TV ose marrësi. Sigurohuni që kabllot video janë lidhur siç duhet.
Telekomanda nuk punon.	Drejtoni telekomandën drejt marrësit. Kontrolloni dhe zëvendësoni bateritë.
Mungon karta smart.	Futni kartën smart dhe sigurohuni që çipi të jetë nga poshtë.
Kartë e gabuar.	Hiqeni kartën smart dhe futeni përsëri siç duhet.

# ELIMINIMI I DUHUR I KËTIJ PRODUKTI



(Mbetje pajisjesh elektrike dhe elektronike) (Aplikohet në Bashkimin Evropian dhe në shtetet e tjera të Evropës me sistem të ndarë grumbullimi të mbetjeve). Kjo shenjë e ngjitur mbi produkt ose udhëzuesit e tij, tregon se në fund të ciklit të jetës, ky produkt nuk duhet të hidhet bashkë me mbetjet shtëpiake. Për të parandaluar dëmtimin e mjedisit dhe të shëndetit të njerëzve nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve, ju lutemi ndajeni nga llojet e tjera të mbetjeve që të riciklohet në mënyrën e duhur për të promovuar ripërdorimin e qëndrueshëm të burimeve materiale. Përdoruesit shtëpiake duhet të kontaktojnë me pikën e shitjes me pakicë ku e kanë blerë aparatit, ose me autoritetin vendor, për të marrë informacion se si dhe ku mund të transportohet ky produkt për riciklim të padëmshëm për mjedisin. Përdoruesit tregtarë duhet të kontaktojnë me furnitorin dhe të verifikojnë kushtet e kontratës së blerjes. Ky produkt nuk duhet të përzihet me mbetjet e tjera tregtare për eliminim.



Zyra Qendrore | +381 38 700 700 | [info@ipko.com](mailto:info@ipko.com) |  
Lagja Ulpiana | Rruga “Zija SHemsiu” | Nr. 34, Prishtinë | [www.ipko.com](http://www.ipko.com)